

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

[21.11.2022]

Drejtuar: *INFOSOFT OFICE SH.P.K*

Autostrada Tiranë- Durrës , km 8 Kashar-Tiranë

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës: REF-40208-08-30-2022

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Tonerash për printera dhe fotokopje”, me fond limit 6,014,079 (gjashte milion e katermbedhjet mije e shtatedhjet e nente) Lekë pa TVSH

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

Operatori ekonomik “ADD Print” me NIPT-L81722022V dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 1,944,888 lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” me NIPT-L82428011G dhe me ofertë ekonomike me vlerë 2,997,000 lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Infosoft Office” me NIPT-J62426002Q dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 1,377,077.6 lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” me NIPT-K81503063B dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 1,727,940.85 lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” me NIPT-L91418502J dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 4,061,200 lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” me NIPT-J72124001N dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 5,779,788 lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Për operatorin ekonomik “Blueprint Technologies” me NIPT-L82428011G, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u evidentuan mangësitë si më poshtë:

Sipas shtojcës 7, pika 2.3.a, duhen të plotësohen këto kritere:

- Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të ketë furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

- Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Përsa më sipër rezulton i paplotësuar nga operatori ekonomik kriteri: “furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi”, pra fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton nën 20% të fondit limit.

2. Për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” me NIPT- L91418502J, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u evidentuan mangësitë si më poshtë:

Për printerin HP DeskJet, (mostra me ngjyra) që është dorëzuar nga operatori ekonomik, nuk ka të identifikuar në përshkrimin e përdorimit të tij, këtë printer.

* * *

Operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k, më datë 17.10.2022 bëri ankesë duke pretenduar se arsyeja e skualifikimit: *“Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat origjinale përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar në pullën e sigurisë tek kutia, (paketimi) e bojës (tonerit), ose në pullën e sigurisë në kartrixhe.”*, pra nuk përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit në kutinë e bojës ose në kartrixhe”, nuk qëndron, pasi AK nuk ka shprehur asnjë kërkesë të tillë për tonerat ekuivalente. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur për këtë ankesë, vendosi me vendim Nr.18 date 20.10.2022 pranimin plotësisht të ankeses nga ky operatore, njekohesisht edhe në zbatim të vendimeve të KPP-se Nr.1045/2022 date 26.10.2022 dhe vendim Nr.1046/2022 date 26.10.2022 të KPP-se ,për sa më sipër KVO vijoi me rivlerësimin e ofertave të skualifikuara me këtë arsye.

U rivlerësuan ofertat për 3 (tre) operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**ADD Print**” me NIPT-**L81722022V** dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 1,944,888 lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**Infosoft Office**” me NIPT-**J62426002Q** dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 1,377,077.6 lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik **“IT Gjergji Kompjuter”** me NIPT-**K81503063B** dhe me ofertë ekonomike, me vlerë 1,727,940.85 lekë pa TVSH.

Nga rishqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik u vlerësuan se ofertat e paraqitur nga operatorët ekonomik **“ADD Print”**, **“Infosoft Office”**, dhe **“IT Gjergji Kompjuter”** janë **me çmim anomalisht të ulët**, sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Bazuar në nenin 93, të ligjit nr. 162/2020 **“Për Prokurimit Publik”**, në pikën 4, të nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, **“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”**, i ndryshuar, përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.
- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së ,oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Duke qënë që ndodhemi përpara rastit të dytë, nga llogaritja rezulton se vlera e ofertës së paraqitur nuk duhet të jetë **nën vlerën 2,531,452**. Për këtë arsye në datë 01.11.2022 me anë të sistemit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik u njoftuan operatorët ekonomik të mësipërm, në mënyrë që të paraqesin argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Nga ana e operatorëve ekonomiku paraqitën informacionet si më poshtë:

- Operatori ekonomik **“ADD Print”**, e paraqiti sqarimin në datën 03.11.2022 (bashkëlidhur dokumentacioni);
- Operatori ekonomik **“Infosoft Office”** e paraqiti sqarimin në datën 04.11.2022 (bashkëlidhur dokumentacioni);
- Operatori ekonomik **“IT Gjergji Kompjuter”**, e paraqiti sqarimin në datën 02.11.2022 (bashkëlidhur dokumentacioni).

Pas shqyrtimit të informacioneve dhe sqarimeve të dërguara nga ana e KVO-së, u pranuan sqarimet e operatorëve ekonomik **“ADD Print”** dhe **“Infosoft Office”**, ndërsa operatori ekonomik **“IT Gjergji Kompjuter”** nuk ka sjellë sqarime sipas kërkesës.

Në këtë moment, operatorët ekonomik janë njoftuar nëpërmjet sistemit në mënyrë elektronike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *INFOSOFT OFICE SH.P.K me adresë Autostrada Tiranë- Durrës , km 8 Kashar-Tiranë* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *1,377,077.6 lekë pa TVSH*. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1045/2022 date 26.10.2022 dh Nr.1046/2022 date 26.10.2022